



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SEKRETARIA

Nr. _____ Prot

Tiranë, më 06.04.2020

NJOFTIM

Për mbledhjen Nr. 15, datë 08.04.2020, ora 13:30 të Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të "Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s" miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19", të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 08.04.2020, ora 13:30** do të zhvillohet mbledhja nr. 15 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Mars 2020
- 2-** Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë "NOA Energy Trade" për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
- 3-** Mbi kërkesën e shoqërisë "Era Hydro" sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Storri" me kapacitet të instaluar 2000 kë
- 4-** Mbi licencimin e shoqërisë "Gega-G" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Prevalli" me kapacitet të instaluar 1750 kW
- 5-** Mbi zgjatjen me 10 ditë pune, të afatit të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë "Gega -G" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
- 6-** Mbi kërkesën e shoqërisë "Albpetrol" sh.a për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE-s
- 7-** Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr.24, datë 10.02.2020, "Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë FTL sh.a
- 8-** Mbi pezullimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal

për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020.

9 – Çështje të brendshme të ERE-s

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI